

VENDIM
Nr. 125, datë 11.2.2015

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË TARIFAVE FIKSE
TË ENERGISË, PËR VITIN 2015, QË DO T'U PAGUHEN PRODHUESVE TË
ENERGISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15, pika 1, e 27, pika 2, të ligjit nr.138/2013, "Për burimet e energjisë së rinovueshme", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Metodologjia e përcaktimit të tarifave fikse të energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet, për periudhën 1.1.2015 - 31.12.2015, do të jetë si më poshtë:
"Çmimi i shitjes" (lekë/kWh), është çmimi mesatar i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent /kWh, x koeficientin 1.24, x normën mesatare të këmbimit euro/lekë për vitin e fundit.

- Me çmim mesatar të vitit përkatës së bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike kuptohet çmimi vjetor mesatar i ponderuar, final i shlyerjes (final settlement price) së energjisë elektrike në bazë (baseload), i produkteve të livruara në segmentin e Kontratave Fizike të së Ardhmes (Physical Futures - PhF) të bursës së Hungarisë (HUPX), ashtu siç publikohet në Raportin Vjetor (Physical Futures Annual Report) të këtij segmenti, për vitin 2014.

Koeficienti 1.24 do të llogaritet për përcaktimin e çmimit të energjisë së prodhuar nga hidrocentralet dhe merr në konsideratë:

i) reduktimin e humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, si pasojë e furnizimit të energjisë elektrike në pikat e lidhjes së këtyre hidrocentraleve me rrjetin energjetik të tensionit të lartë dhe/ose të mesëm;

ii) kostot e shmangura të transmetimit të energjisë nga importi;

iii) kostot e shpërndarjes së kapaciteteve të interkoneksionit; si dhe

iv) nxitjen e shfrytëzimit të burimeve të rinovueshme deri në arritjen e objektivave të detyrueshme kombëtare për pjesën e energjisë së përdorur nga burime të rinovueshme të energjisë në konsumin përfundimtar bruto të energjisë, në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë.

- Me normë mesatare të këmbimit euro/lekë të vitit të fundit kuptohet kursi mesatar vjetor i këmbimit euro/lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin 2014.

2. Deri në datën kur do të bëhet publik Raporti Vjetor i HUPXPhF (për vitin 2014), çmimi i shitjes së energjisë së prodhuar nga prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike do të përcaktohet nga ERE, duke përllogaritur çmimin e energjisë elektrike për produktin në bandë, të parashikuar për vitin 2015 sipas bursës HUPX, x koeficientin 1.24 x normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin 2014.

Diferencat që mund të rezultojnë nga ky përcaktim do të rregullohen nga ERE, në momentin e miratimit të çmimit të miratuar për vitin 2015 (pika 1).

3. Në vendimin nr.27, datë 19.1.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, paragrafi i tretë dhe të tjerët në vijim të pikës 2, të kreut IV, "Dokumentet standarde të procedurës konkurruese", shfuqizohen.

4. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama